

UDC 316.77:316.347

Gëzim Xhambazi, PhD³¹⁶

MEDIAT E REJA DHE IDENTITETI

НОВИТЕ МЕДИУМИ И ИДЕНТИТЕТОТ

THE NEW MEDIA AND THE IDENTITY

Abstract

Every community possesses special characteristics that distinguish them from other groups, the same applies to personal identity that differs from any other identity. Generally, identity is not unchangeable component individually or in groups, depending on the circumstances and situations undergoes changes. National and religious affiliation as components of identity are shown as resistant to change and development. Today there are different approaches to identity, as development pressures are versatile, especially telecommunication and information technologies is very large. New technologies, in particular telecommunications enabling disappearance of geographical distance and time allowing individuals knowing each other, communication and information in real time to various community members from around the world. Previous studies were focused on research on the impact of various media (radio, television, newspapers) on social strata. Today the internet, computers and especially smart phones, joined all media and unequivocal impact on the construction of personal and group beliefs in society is greater.

³¹⁶ Doktor në shkencat sociologjike, Universiteti Shtetëror i Tetovës, gezimxh@yahoo.com

Unambiguously that a combination or merger of such media will have an effect on the most resistant components that make identity.

Keywords: *identity, development, new media*

Abstrakt

Çdo komunitet posedon karakteristika të veçanta të cilat e dallojnë prej grupeve tjera, e njëjta vlen edhe për identitetin personal i cili dallon nga çdo identitet tjetër. Përgjithësisht, identiteti nuk është komponentë e pandryshueshme individuale apo grupe, ai varësisht nga rrethanat dhe situatat pëson edhe ndryshime. Përkatesia nacionale dhe fetare si përbërës të identitetit janë treguar si më rezistente ndaj ndryshimeve dhe ndaj zhvillimit. Sot ekzistojnë qasje të ndryshme rreth identitetit, pasi që presioni që ushtron zhvillimi i gjithanshëm, sidomos teknologjitë telekomunikative dhe informatike është shumë i madh. Teknologjitë e reja, në veçanti ato telekomunikative mundësojnë zhdukjen e distancave kohore dhe gjeografike duke u mundësuar individëve njohjen, komunikimin dhe informimin në kohë reale me pjesëtarë të komuniteteve të ndryshme nga mbarë bota. Studimet e deritanishme fokusoheshin në hulumtimet mbi ndikimin e mediave të ndryshme (radio, televizionit, gazetave) ndaj shtresave shoqërore. Sot interneti, kompjuterët dhe sidomos smartfonët, bashkuan të gjitha mediat dhe pamëdyshje ndikimi i tyre në ndërtimin e bindjeve personale dhe grupe në shoqëri është më i madh. Pamëdyshje se një kombinim ose bashkim i këtyre mediave do të ketë ndikim edhe në komponentet më të rezistueshme që përbëjnë identitetin.

Fjalë kyçe: *identitet, zhvillim, media të reja*

I. Mediat në shoqëritë demokratike

Shoqëritë e sotshme demokratike janë në kulminacionin e zhvillimit, si në aspektin material ashtu edhe në atë shpirtëror. Ky

duket një konstatim shumë i njëanshëm sepse tejkalimi i problematikave tekniko-teknologjike si dhe të atyre sociale, të cilat në vazhdimësi pengonin mirëqenien njerëzore, çdo herë ka inicuar çështje të reja, të cilat për të kaluarën ishin të panjohura. Rrethanat socio-ekonomike dhe ato kulturore gjithmonë janë pjesë e cikleve të zhvillimit në përgjithësi. Aspekti kohor i ndryshimeve shoqërore varet prej shpejtësisë së përhapjes dhe distribuimit të informacionit. Përderisa në të kaluarën nevojitej kohë më e gjatë për përhapjen e ndodhive shoqërore, ose shpesh ato nuk guxonin fare të përhapeshin, rezultonte me një nënshtrim të shoqërisë ndaj gjendjeve aktuale. Ata pranoreshin si të tilla dhe nuk ndërmerrej asnjë veprim për tejkalimin e tyre. Varësisht sistemeve politike, masat e gjera popullore ndikoheshin nëpërmjet mediave, të cilat i nënshtroheshin një censure të kontrolluar në çdo detaj. Si pasojë e mos senzibilizimit të çështjeve shoqërore, shumë veprimtari mbeteshin me vite të tëra në favor të pengimit zhvillimor të shoqërisë.

Tejkalimi i këtyre gjendjeve fitoi në intensitet kohor dhe hapësinor, me zhvillimin e teknologjive telekomunikative, sidomos të kompjuterëve dhe rrjeteve për bartjen e informacioneve. Këto teknologji nuk njohin kohë dhe hapësirë, gjithçka ndodh dhe zhvillohet në kohë reale. Kompjuterët arritën të bashkojnë të gjithë mediat ekzistuese, duke ndihmuar dhe konsoliduar të njëjtat në të gjitha aspektet. Fillimi i mijëvjeçarit të ri karakterizohet me zhvillimin e mediave elektronike ose mediave të reja, të cilat fuqishëm ndikojnë në jetën e përditshme të çdo individi. Për këtë arsye, këta media me të drejtë emërtohen edhe si pushteti i katër në shtet. Gara për posedimin e mediave zhvillohet nga të gjitha palët, si ato që qeverisin ashtu edhe nga ato që duan të senzibilizojnë ose të tejkalojnë problemet e përditshme. Kjo dukuri vuri në sprovë të dyja palët, të parat duke punuar në mënyrë intensive për të ruajtur rendin dhe disiplinën mediatike me çka censurimi i informacioneve të padëshirueshme është shumë i rreptë. Pala tjetër çdo herë është në kërkim të anomalive drejtuese dhe udhëheqëse të shoqërisë, nëpërmjet të

cilave fiton respektin e masës si një auditor i papërcaktuar në këtë teatër të përditshëm.

Mediat çdo herë kanë luajtur rol të rëndësishëm në shoqëri, nëpërmjet tyre janë favorizuar, penguar apo shkatërruar shumë çështje shoqërore. Ato kanë arritur të ndikojnë edhe në vlerat më të rëndësishme dhe më rezistente njerëzore. Fuqia mediatike ka arritur të prekë edhe identitet individuale dhe kolektive të njeriut.

1.1 Gjuha si mjet komunikimi

Gjuha është komponentë kryesore e cila dallon njeriun nga qeniet e tjera në natyrë. E folur apo e shkruar, gjuha si mjet komunikimi ndihmoi njeriun në të gjitha aspektet. Në kontekstin e sotshëm mediatik gjuha vazhdon të mbetet mjet i rëndësishëm komunikimi. Ndërmjet gjuhëtarëve dhe inxhinierëve të telekomunikacionit, si dy veprimtari jo të afërta, mendohet se ekziston mosmarrëveshje. Në popullarizimin e teorisë së informacionit mes gjuhëtarëve, kontribut të rëndësishëm dha Roman Jakobsoni, sipas të cilit mes gjuhëtarëve dhe inxhinierëve nuk ekziston ndonjë kundërthënie e rëndësishme. Dallimi është se inxhinierët e telekomunikacionit punuan shumë më shpejt se sa gjuhëtarët, për arsye se kanë më shumë dije mbi gjuhën se sa gjuhëtarët mbi telekomunikacionin (Jakobson R., 1963. 24-42). Për inxhinierët e telekomunikimit përmbajtja e informacionit nuk ka asnjë rëndësi, detyrë parësore e tyre është mundësimi i transferit të sigurt të informatave. Dhe jo vetëm kaq, problematika aq më tepër thellohet midis vetë gjuhëtarëve. Që në vitin 1916, studiuesi francez Sosier parashtrroi një hierarki mjaft diskutabile midis gjuhës dhe të të folurit. Sipas tij, gjuha objekt studimi ka vetëm gjuhën dhe jo të të folurit. Nga ky këndvështrim zhvillohen shumë debate dhe studime nga autorë të ndryshëm, mes të cilëve edhe nga studiuesi gjuhësor me përmasa botërore Noam Çomski, sipas të cilit gramatika është ajo që i kundërvihet të të folurit konceptual.

Gjuha është faktori më i rëndësishëm dhe i pandryshueshëm në ruajtjen dhe kultivimin e identitetit si vlerë më e lartë individuale dhe kolektive. Çdo individ identifikohet me njerëzit të cilët flasin të

njëjtën gjuhë me të, në këtë mënyrë përcakton qartë përkatësinë ndaj grupit që i takon. Shikuar nga aspekti historik, bashkësitë homogjene asnjëherë nuk kanë ekzistuar, ashtu siç nuk ekzistojnë edhe sot, nga vet fakti se gjuha që flasin pjesëtarët e një shoqërie nuk është homogjene (Baylon Ch., & Xavier M., 2003, 188). Sipas këtij konkluzioni mund të theksojmë se heterogjeniteti i bashkësive shoqërore, në radhë të parë është rezultat i heterogjenitetit gjuhësor. Shpërndarja jo e barabartë e grupacioneve njerëzore në aspektin gjuhësor, ka mundësuar ndarjen e popullatës në shumicë dhe pakicë, ku pjesëtarët e pakicës shpesh janë të injoruar nga shumica, për arsye se flasin gjuhë tjetër. Si pasojë e gjendjes së pazhvilluar në aspektin arsimor dhe kulturor, sot njihen edhe gjuhë të shkrira. Pjesëtarët e pakicave në vende të caktuara, në pamundësinë e ruajtjes dhe kultivimit të gjuhës amtare, ishin të pafuqishëm edhe në ruajtjen e identitetit nacional. Dukuri të tilla njihen edhe sot, ku popullata shumicë insiston në kultivimin e multikulturës si modalitetin më të sigurt të bashkëjetesës mes grupacioneve të ndryshme, por gjithmonë duke favorizuar kulturën dhe gjuhën e shumicës.

Në trendet e globalizimit vërehet një garë e fuqishme mes gjuhëve të mëdha botërore, të cilat imponuan nevojën për njohjen dhe mësimin e tyre nga përfaqësuesit e grupacioneve të ndryshme nga mbarë bota. Ata shkuan deri aty, sa që këto gjuhë fëmijët i mësojnë paralelisht me gjuhën amtare. Kjo ndodh si pasojë e fuqisë politike dhe ekonomike nga njëra anë, dhe fuqisë së ndikimit mediatik nga ana tjetër. Shumë shprehje të gjuhëve botërore çdo ditë e më shumë bëhen pjesë e gjuhëve të ndryshme, të cilat në mënyrë shumë efikase zëvendësojnë fjalë dhe shprehje ekzistuese të gjuhës amtare.

II. Ndikimi i mediave në identitetin e njeriut

Zhvillimi i teknikës dhe teknologjisë vërehet çdo ditë, njerëzit flasin për ndryshime dhe zbulime, dhe aq më tepër mësohen që këto dukuri të bëhen përditshmëri e tyre. Krahas kompjuterëve, sot në zhvillim e sipër është edhe smart teknologjia. Në funksionimin sa më efektiv të tyre nevojiten pjesëmarrës të pesë niveleve, edhe atë:

sigurues tregjesh, prodhues të përmbajtjeve dhe shërbimeve, konstruktorë të rrjeteve, operatorë të rrjeteve dhe aplikues për qasje-provajerë (Goldberg. D., Proeser. T., dhe Verhulst. S., 1998, 27). Vendet e pazhvilluara dhe ato në zhvillim as që mund të bëjnë tentim për sigurimin e funksionimit efektiv të teknologjive të reja. Nga ana tjetër, baza e dobët financiare dhe materiale e këtyre vendeve as që llogaritet kur në pyetje janë këto teknologji. Kompjuterët dhe pajisjet tjera telekomunikative i has në të gjitha shoqëritë në zhvillim. Arsyet janë të shumta, në radhë të parë ata distribuohen nga ana e prodhuesve në forma të ndryshme dhe me qëllime afatgjata, për çka edhe subvencionohen nga shtetet prodhuese. Ndikimi i tyre në masat e gjëra popullore është i madh, kurse mundësia e shprehjes individuale nga secili individ është e patjetërsueshme.

Informatat e shumta të plasura dhe të shpërndara nëpërmjet këtyre mediave mundësuan edhe ndryshimin e transaksioneve kulturore. Mediat e reja arritën të ndërhyjnë edhe në mënyrën e jetës, të mendimit dhe të traditës, si karakteristika të forta të një bashkësie nacionale ose fetare. Dhe si rezultat i ndikimit dhe presionit të fortë disa bashkësi nacionale ose fetare në vende të caktuara filluan të ndryshohen bile edhe të shkatërrohen.

Rrjedhja e informatave sekrete shtetërore nga ana e Wikiliksit, ndikim më të madh pati në botën arabe. Mediat sekulare të këtyre vendeve mbanin peng progresin e identitetit nacional, kurse mediat botërore në vazhdimësi etiketonin shtetet arabe me terminologjinë më të vrazhdët gjuhësore. Në këtë mënyrë sa vinte e dobësohej identiteti fetar. Ndjenjën për problemin e identitetit të unifikuar fetar te këto vende e nxitën po ata që e shkaktuan, mediat vendase dhe ato botërore. Pasoja e kësaj gjendje të krijuar, rezultoi me lëvizje popullore në drejtim të rrënimit të qeverive, por shpejt u konstatua se çështja është shumë më e thellë.

Përfundim

Mediat janë arma më e fortë e Fuqive të Mëdha. Nëpërmjet tyre, ata ndikojnë fuqishëm në mënyrën e jetës së njerëzve, në

nxitjen apo shuarjen e konflikteve në vende të ndryshme të botës. Ata kanë ndikim edhe në luftë edhe në paqe, përdoren edhe për të shuar mosmarrëveshje reale edhe për të nxitur konflikte ireale. Këto pikëpamje nuk janë të panjohura nga masat e gjëra popullore, por ata gjithmonë bien në grackat mediatike. Sot zhvillimi i mediave të reja së bashku me benefitet e tyre mundësojnë ndërhyrjen edhe në vlerat më të larta njerëzore. Rrjedhat e sotshme globale, në aspektin social dhe shpirtëror janë duke krijuar kushte të favorshme për ndërhyrje në identitetin e njeriut.

Conclusion

The media are the strongest weapon of the Great Powers. By means of them, they strongly influence the people's way of life, in encouraging or defuse conflicts in different countries of the world. They have an impact on the war and in peace too, they are also used to extinguish the real disagreements and to foster unreal conflicts. These views are not unknown by the masses, but they always fall into the media traps. Today the development of new media jointly with their goodness enable their intervention in the highest human values also. Today's global trends in social and spiritual are creating favorable conditions for intervention in human identity.

Literatura

1. Baylon Ch., & Xavier M., (2003), La communication, Nathan-Universite
2. David, M.G., (2003), Socijalpsikologjia, Tiranë: Uegen
3. Dragoti, E., (1999), Psikologjia sociale, Tiranë: Libri Universitar
4. Голдберг.Д., Просер.Т., и Верхулст.С.,(ed), (1998), Регулирање на медиумите: Компаративна студија, Оксфорд.
5. Jakobson.,R, (1963), Essais de linguistique generale, Paris
6. Pajaziti, A., (2009), Fjalor i sociologjisë, Logos-A, Shkup/Prishtinë/Tiranë

7. Research Center in Gender Studies “Euro-Balkan” Institute,
Identities. Journal for politics, Gender, and Culture. Vol. III.
No.2, Winter 2004, Skopje